

VENDIM
Nr. 549, datë 16.8.2012

**PËR KUOTAT E PRANIMIT DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT NË DISA INSTITUCIONE PUBLIKE
TË ARSIMIT TË LARTË PËR CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE “MASTER PROFESIONAL”, ME
KOHË TË PLOTË, PËR VITIN AKADEMIK 2012-2013**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 24, 34, 35, 36 e 75 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8098, datë 9.4.1996 “Për statusin e të verbrit”, të ligjit nr. 8626, datë 4.7.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 7889, datë 14.2.1994 “Për statusin e invalidit”, të ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, si dhe të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, për programet e studimeve të ciklit të dytë “Master profesional”, me kohë të plotë, për vitin akademik 2012–2013, të jenë 9658, të ndara si më poshtë vijon:

- | | |
|---|-------|
| a) Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit “Master profesional” | 9368; |
| b) Kuotat për programe të dyta studimi | 100; |
| c) Kuotat për transferimin e studimeve | 100; |
| ç) Kuotat për shtetas të huaj | 50; |
| d) Kuotat për të verbrit | 20; |
| dh) Kuotat për romët/ballkano-egjiptianët | 20. |

2. Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit “Master profesional”, me kohë të plotë, sipas shkronjës “a” të pikës 1 të këtij vendimi, përbëhen nga:

- | | |
|---|-------|
| a) kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit “Master profesional”, për kandidatë brenda territorit të vendit | 8968; |
| b) kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit “Master profesional”, për kandidatët shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit | 400. |

3. Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional”, me kohë të plotë, sipas shkronjës “a” të pikës 2 të këtij vendimi, sipas programeve të studimit dhe institucioneve publike të arsimit të lartë që i ofrojnë këto programe, pasqyrohen në tabelën nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional”, me kohë të plotë, sipas shkronjës “b” të pikës 2 të këtij vendimi, të cilat ndahen ndërmjet kandidatëve shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit nga: Republika e Kosovës, Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, pasqyrohen në tabelën nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

Kandidatët nga Republika e Kosovës, e Maqedonisë, e Malit të Zi dhe nga prefekturat e Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjës, aplikojnë direkt në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë. Rishpërndarja e kuotave të paplotësuara kryhet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, duke marrë parasysh edhe kërkesat e institucioneve të arsimit të lartë publik.

5. Kuotat e pranimeve sipas shkronjës “d” të pikës 1 të këtij vendimi, për personat që nuk shikojnë, administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bazë të listës së hartuar nga Shoqata Kombëtare e të Verbërve.

6. Kuotat e pranimeve sipas shkronjës “dh” të pikës 1 të këtij vendimi, për romët dhe ballkano-egjiptianët, administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në bazë të listës së hartuar të shoqatave respektive, Shoqatës Kombëtare të Romëve dhe Shoqatës Kombëtare të Ballkano-Egjiptianëve.

7. Kuotat e pranimit për shtetasit e huaj që do të studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë, në ciklin e dytë të studimeve, sipas shkronjës “ç” të pikës 1 të këtij vendimi, administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas marrëveshjeve dy apo shumëpalëshe ndërmjet vendeve.

8. Kuotat e pranimeve për një program të dytë studimi dhe transferimi i studimeve të përcaktuara në shkronjat “b” dhe “c” të pikës 1 të këtij vendimi, shpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, bazuar në kërkesat e institucioneve publike të arsimit të lartë.

9. Çdo program studimi i ciklit të dytë “Master profesional”, me kohë të plotë, funksionon në vitin e parë, për vitin akademik 2012–2013, në rast se atë e ndjekin, të paktën 10 studentë.

10. Institucionet publike të arsimit të lartë përcaktojnë kriteret e pranimit të kandidatëve dhe i bëjnë publike paraprakisht.

11. Tarifat e shkollimit për çdo kredit, për studentët që do të regjistrohen në vitin e parë, për të gjitha programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional”, me kohë të plotë, në vitin akademik 2012-2013, përcaktohen në tabelën nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

12. Tarifat e përgjithshme të shkollimit për studentët që do të regjistrohen në vitin e parë, për të gjitha programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional”, me kohë të plotë, në vitin akademik 2012-2013, përcaktohen në tabelën nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

Pagesa e tarifës bëhet me këste, të përcaktuara nga institucioni i arsimit të lartë. Pas përfundimit të kohëzgjatjes normale të programit të studimit, studentët që nuk e kanë përfunduar ende programin përkatës, paguajnë vetëm tarifën për kredit të lëndëve të prapambetura.

13. Kandidatët që do të fitojnë të drejtën për të ndjekur një program studimi të ciklit të dytë “Master profesional”, me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë në vitin akademik 2012-2013, dhe që u përkasin shtresave sociale të personave që nuk shikojnë dhe që nuk dëgjojnë, invalidë, invalidët e punës dhe fëmijët e tyre, paraplegjikë dhe tetraplegjikë, fëmijët që gëzojnë statusin ligjor të jetimit, fëmijët romë, ballkano-egjiptianë apo fëmijët e policëve dhe ushtarakëve të rënë në krye apo për shkak të detyrës, si dhe fëmijët e ish-të përndjekurve politikë, paguajnë një kuotë në masën 50% të tarifës së shkollimit.

14. Në çdo program studimi të ciklit të dytë të studimeve “Master profesional”, me kohë të plotë, studentët e shkëlqyer nuk e paguajnë tarifën e shkollimit, në vitin akademik 2012-2013.

15. Shtetasit e huaj që do të vazhdojnë studimet e ciklit të dytë në institucionet publike të arsimit të lartë, i nënshtrohen së njëjtës tarifë shkollimi, si shtetasit shqiptarë, me përjashtim të rasteve kur me marrëveshje ndërshtetërore, është parashikuar ndryshe.

16. Transferimet e studimeve sipas shkronjës “c” të pikës 1 të këtij vendimi, në numrin përkatës të kuotave për program, të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, bëhen nga vetë institucionet publike të arsimit të lartë, sipas kriterëve të përcaktuara në aktet nënligjore, në statutet dhe rregulloret e tyre.

17. Studentët që përfitojnë nga kuotat e përcaktuara në shkronjat “b” dhe “c” të pikës 1 të këtij vendimi, i nënshtrohen tarifës së shkollimit të programit përkatës të studimit që ata kanë kërkuar.

18. Rishpërndarja e kuotave të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, të cilat mbeten të parealizuara, bëhet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në bashkëpunim me institucionet publike të arsimit të lartë.

19. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha